

DEKRET
Nr. 202, datë 8.4.2026

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës; nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Kalorës i Urdhrit të Lisit Akademik”
zonjës Shqiponje Xhevahir Telhaj**

“Në vlerësim të meritave në fushën e kërkimit shkencor, të hartimit e të këshillimit të politikave publike në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Shqipëri, ku me përkushtim dhe profesionalizëm ka dhënë e vijon të japë, edhe si titullare dhe anëtare e një sërë strukturash strategjike kombëtare, një kontribut të spikatur në zhvillimin e politikave të ndërthurura në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm në arsim dhe në ekonomi”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj